

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ERILD 22“ sh.p.k.**

Në Tiranë, sot më datë 18/11/2022 :

Z.Erjon Dule, person me shtetësi shqiptare, i datelindjes 22/08/1982. Mbahtes i Leternjoftimit me Nr. **ID 120822048G**, banues ne Tirane

Znj. Grisilda Dule person me shtetësi shqiptare, i datelindjes 04.02.1991. Mbahtes i Leternjoftimit me Nr. **ID J15204060T**, banues ne Tirane

Në cilësinë e “ortakeve themelues“ ka rene dakort per hartimin e ketij akt themelimi , nëpëmjet të cilit deklarojne se me vullnet të lirë, të plotë e të sigurtë, dhe iniciativën e lirë private, mbështetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare“, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit“, në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojnë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, “**ERILD 22 “ sh.p.k**

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqëria “**ERILD 22 “ sh.p.k.**, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Pergjegjësi te Kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.
Shoqëria “**ERILD 22 “ sh.p.k.**, është një shoqëri tregtare me pergjegjesi te kufizuar.

Neni 3
Selia

Shoqëria “**ERILD 22” Sh.p.k** e ka seline e saj ne adresen: Rruga“Xhavit Isufi”,Pallati , NR 1, Njesija nr 2, ZK 2460, Qesarake,Dajt,Tirane. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, vetem me vendim te asambleese se pergjitheshme, si edhe të hapë zyra perfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, nepermjet vendimit vetem nga Administratoret

Neni 4
Objekti i veprimtarisë

Kryerja e punimeve ndertimore ne , hidrocentrale, ndertime civile dhe ushtarake sipas legjislacionit ne fuqi. Perpunimi dhe eksportimi i energjise .Kerkim, zbulim, shfrytezim energjie si dhe te llojeve te tjera te saj Importimi, perpunimi dhe tregtimi i energjise te te gjitha llojeve . Prodhim, Importim, eksportim i mallarave te ndryshem. Prodhimin dhe tregtimin e produkteve, me baze energji, per te gjithë sektoret e ekonomise. Prodhimin dhe tregtimin e produkteve, me baze materiale te ndryshme, per te gjithë sektore e ekonomise. Marrja pjese ne tendera dhe ankande si dhe kryerja e sherbimeve qe kane lidhje me objektin e veprimtarise se saj. Blerje pasuri e luajtshme dhe e paluajtshme, ti marre ose ti leshoje me qira, te marre tendera. Tregtim i materialeve te ndryshme me shumice dhe pakice ne format e parashikuara dhe te lejuara nga legjislacioni shqiptar. Tregtim i mallrave te ndryshem me shumice dhe pakice,industriale,te ndertimit, ushqimore e te tjera, eksportin dhe importin e tyre ne perputhje me ligjin dhe me formen e shoqërise, tregtim te prodhimeve te ndryshme ushqimore ose jo , me shumice dhe pakice eksportin dhe importin e tyre. Shoqëria mund te kryeje ne permbushje te qellimeve te saj cdo lloj operacioni tregtar, mund te vendose pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, dhe ti hipotekojë keto ne emrin e saj. Tregtim,



importim dhe eksportim te lendeve ambalazhuese dhe prodhimeve te tyre si dhe industrine e tyre me shumice dhe pakice. Kontraktim, marrja apo dhenie ne lidhje me fushen e veprimtarise se saj te cdo lloj kreditimi me afat te shkurter te mesem apo te gjate ne tregjet e brendshme apo te jashtme, te mundesoje kredi mallrash, pengjesh, importimi dhe eksportimi. Te perfitoje, transferoje, te marre me qira, te bleje dhe te shese, si dhe te kontraktoje te drejten e markes , patentes, licenses dhe te drejta te tjera qe jane te ngjashme me keto. Tregetim me shumice e pakice, prodhimin,importi dhe eksporti i te gjitha llojeve te mallrave te lejuara nga Ligji, brenda dhe jashte vendit, per llogari te vete shoqerise si dhete te treteve.Te kryeje veprimtari ne sektorin imobiljar ,shitje,blerje,qira te pasurive te paluajtshme.

Çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, mund të kryejë cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali i shoqërisë është 100.000 Lekë. Kapitali i shoqërisë është i përbërë nga 2 kuota me vlerë, si me poshte:

Z. Erjon Dule, zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 70% te kapitalit të shoqërisë me vlere 70000 (shtatedhjetë mijë) lek ,

Znj Grisilda Dule, zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 30% te kapitalit te shoqerise ne vleren e 30000(tridhjetë mijë) lekeve

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë te tregëtueshme.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme ose të paluajtshme apo të drejta)

Ortaket përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri ne vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.



KREU II
ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarrës

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm në rast se shoqëria është e themeluar nga një ortak i vetëm. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos për çështje si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- j) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- k) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- l) investime;
- ll) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- m) të bleje, shese, kembeje pasuri të patundshme të shoqërisë;
- n) për shpërndarjen e fitimit.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaket regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.


Neni 9
Administrimi

Administrator i shoqërisë është **Skënder Dule**, mbajtese e kartes së identitetit nr ID **F91030026V** i emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.
Administratorët emerohen dhe shkarkohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 10
Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara



asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) Te hape llogari bankare dhe te operoje per llogari te kompanise pa limit.

f) te kerkoje financime pa limit per kompanine nga banka apo institucione te tjera financiare;

g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e asamblesë së përgjithshme edhe në rastet kur : sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe

kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Me përjashtim të vitit të parë financiar që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 12

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14

Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi uredaktua në 3 kopje në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike. Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaket themelues i shoqërisë tregtare “ERILD 22 “ *sh.p.k* , nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij orgjinale.

**ORTAKET E SHOQERISE
“ERILD 22”**

ERJON DULE

Erjon Dule


GRISILDA DULE

Grisilda Dule
